



Agjencia për Pronësi Industriale
Agencija za Industrijsku Svojину
Industrial Property Agency

Bujqësia dhe Pronësia Intelektuale



*Inovacioni dhe tradita
Nën mbrojtjen e IP-së*

Përmbajtja

Përmbajtja	2
Shkurtesat	3
Hyrje	4
1. Të Drejtat Pronësore Intelektuale dhe bujqësia	5
1.1. Patenta	5
1.2. Mbrojtja e varieteteve të bimëve	7
1.3. Treguesit Gjeografik	9
1.4. Markat Tregtare	10
1.5. Sekreti Tregtar	12
2. Raste Studimi	14
3. Mesazhe me rëndësi	18
4. Linqe me rëndësi	19

Shkurtesat

DPI	- Drejtat Pronësore Intelektuale
API	- Agjencia për Pronësi Industriale
MT	- Marka tregtare
MBPZHR	- Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
TGH	- Treguesit Gjeografik
ST	- Sekreti Tregtar



Hyrje

Pronësia intelektuale ka gjetur shfrytëzim të madh për mbrojtjen e produkteve dhe shërbimeve në fushën e bujqësisë. Me bujqësi nënkuptojmë veprimtarinë ekonomike të cilat ka si objekt prodhimin e ushqimit për njerëz, kafshë, bimë industriale, bio-karburante, si dhe produkte të tjera me origjinë bimore dhe shtazore. Sigurimi i ushqimit dhe kualitetit të tij, është shumë i rëndësishëm për ekonominë dhe vet shtetin, por edhe sfidë. Sidomos nëse marrim parasysh kohën në të cilën po shkruhet ky material ku çmimet e produkteve ushqimore kanë shkuar në qiell.

Bujqësia, përkatësisht subjektet që merren me bujqësi, në të gjitha hallkat e saj, krijojnë produkte të cilat janë shumë të rëndësishme të jetën tonë, për dallim nga produkte e tjera të cilat mbrohen me të drejta pronësore intelektuale (DPI), gjithashtu këto produkte apo shërbime paraqiten si esenciale për jetën tonë.

Viteve të fundit ka pas një zhvillim të hovshëm të bujqësisë dhe rritjes së rendimenteve edhe në sektorin e bujqësisë, kjo fal inovacionit, teknologjisë së re, varieteteve të reja bimore dhe të ekonomisë së bazuar në njohuri dhe informacion. Të gjitha këto kërkojnë investim dhe mund, dhe për këtë arsyeje ndër të tjera është me rendësi që mbrohen DPI-të. Të cilat japin mundësi ligjore për mbrojtjen e kreativiteti, novacionit dhe njohurive që aplikohen në bujqësi. Por edhe sigurojnë mundësinë për marrjen e teknologjisë nga jashtë për zhvillimin e bujqësisë.

Një pjesë e madhe e ekonomisë së vendit tonë është e bazuar në bujqësi, dhe ka shumë persona e ndërmarrje të cilat merren intensivisht me bujqësi. Sektori i bujqësisë në Kosovë, për të realizuar potencialin e tij duhet të jetë më novativ, të përdor teknologjinë dhe ti përgjigjet nevojave të tregut. Produktet të cilat prodhohen në kuadër të kësaj industrie mund të mbrohen me të drejta pronësore intelektuale.

Njohuritë për DPI janë mundësi e mirë, që këta persona e ndërmarrje të mbrojnë produktet, kreativitetin dhe novacionin e tyre nga kopjimi dhe përdorimi i padrejtë, por edhe të kenë njohuri të mos i shkelin të drejtat e të tjerëve.

Përmes këtij materiali kemi për qëllim të bëjmë të njohura DPI-të të cilat mund të përdoren për mbrojtjen e produkteve dhe shërbimeve në kuadër të sektorit të bujqësisë dhe për të treguar se si këto të drejta mund të përdoren për tu zhvilluar bizneset e rritur inovacioni në këtë sektor.

DPI mund të sigurojnë investime nga investitorët, të ardhura nga licencimi, dhe të parandalojë hyrjen e konkurrentëve në treg, andaj janë shumë të rëndësishme si të drejta për veprimtarinë dhe biznesin tuaj.

1. Të Drejtat Pronësore Intelektuale dhe Bujqësia

Produktet në sektorin e bujqësisë në vete përfshinë inovacion dhe kreativitet duke filluar nga prodhimi, mbjellja e mbledhja, transporti, procesimi, distribuuimi, paketimi dhe bartja e këtyre produkteve, të gjithë veprime këto, kryhen falë shumë mjeteve të punës, farërave e varieteteve bimore, njohurive, novacionit, dijes e informacionit që në forma të ndryshme mbrohet me të drejtat pronësore intelektuale. Deri tek metodat më të reja digjitale të bujqësisë dhe veprimtarisë ekonomike ku aplikohen teknologjia dhe inovacioni gjerësisht. Pra ky është një sektor i gjerë.

Në këtë sektor mund të përdoret DPI për të siguruar mbrojtje nga kopjimi dhe përdorimi i pa autorizuar i patentave, varieteteve të bimëve, markave tregtare, treguesve gjeografik e deri te sekretet tregtar.

Është me rëndësi që edhe krijuesit, novatorët e personat përgjegjës në ndërmarrje e biznese të këtij sektori, të kenë njohuri për këto të drejta, që të mos i shkelin ato kur krijojnë produktet e tyre.

1.1. Patenta

Mbrojtja me patentë është njëra ndër format e mbrojtjes për produktet bujqësore. Produktet bujqësore si drithërat, pemët, perimet, qumështi, mishi, peshku, pastaj farërat, makineria, agro-kimikatet e ndryshme, fertilizuesit dhe produktet që ndihmojnë në rritje, bio-teknologjia, trajtimi i farërave, mjetet e punës e deri tek digjitalizimi, të gjitha janë një gamë e gjerë e produkteve dhe mjeteve që mund të mbrohen me patentë nëse i plotësojnë kushtet e parapara dhe nuk janë të përjashtuara nga patentimi.

Novacioni dhe teknologjia në industrinë e bujqësisë është shumë me rëndësi, për të krijuar produkte më rentabile, më të qëndrueshme ndaj temperaturave, sëmundjeve, apo për teknologji e mjete pune që ndikojnë pozitivisht si në aspekt të kryerjes së punëve ashtu edhe të rritjes së rendimenteve.

Mbrojtja me patentë, u lejon subjekteve të nxjerrin investimet dhe kostot për hulumtim, pasi që shembull për një produkt të ri apo proces mund të kalohen vite kohë hulumtimi në laborator, në anën tjetër publiku përfiton pasi që duhet bëhet publik i tërë informacioni mbi të cilin është i bazuar inovacioni.

Me patentë, mund të mbrohet një produkt ose proces që është i risi, përmban hap shpikës dhe ka përdorim në industri. Shembull me patentë mund të mbrohen materialet biologjike, jo-biologjike apo mikrobiologjike të bimëve, ku bëjnë pjesë farat, pjesët e ndara të AND-së të bimëve, proteina të izoluar, e produkte të tjera mikrobiologjike. Ose mund të mbrohet një proces për prodhimin e bimëve, ku do të mbrohej edhe bima që prodhohet përmes këtij procesi.

Kushdo që përdorë produktet ose procesin e patentuar, ka për obligim të merr autorizim nga mbajtësi i të drejtës së patentës. Pra patenta sjellë mbrojtje, por edhe mund të përdoret për të siguruar të hyra për ata që investojnë në kërkime e inovacion.

Viteve të fundit fal shpikjeve dhe inovacionit është rritur edhe përdorimi i teknologjisë së re në lidhje me përdorimin e ujit, tokës, pesticideve apo fertilizuesve në bujqësi, me qëllim të racionalizimit dhe përdorimit më preciz të tyre, këto teknologji të reja janë patentuar dhe sigurojnë kthim të investimeve për mbajtësit e të drejtave.

Shpikja nuk duhet t'i zbulohet askujt para regjistrimit të patentës, pasi që nëse bëhet kjo atëherë shpikja nuk do të jetë risi dhe nuk do të mund të patentohet. Shpikja duhet të jetë një risi absolute në krahasim me të gjithë njohurinë dhe informacionin në të gjithë botën. Duhet të ruhet konfidenciale dhe të shmanget çdo zbulimi apo publikimi (përfshirë shitjen, botimin, prezantimin, etj.). Vetëm shpikjet që janë risi, që përmbajnë hap shpikës e që janë të zbatueshme në industri mund të patentohen.

Shpikja mund të patentohet nëse plotëson këto kushte sipas legjislacionit të Republikës së Kosovës [Liqi Nr. 08-L-059 për Patentat](#), që përbën:

Risi - Shpikja konsiderohet e re nëse nuk bën pjesë në njohuritë e mëparshme. Njohuria e më parshme përbëhet prej gjithë asaj që i është vënë në dispozicion publikut në nivel botëror me anë të përshkrimit të shkruar ose gojor, përdorimit, ose në ndonjë mënyrë tjetër, para datës së dorëzimit të aplikimit për patentë;

Shkalla e risisë apo hap shpikës - Shpikja konsiderohet se përmban shkallë të risisë nëse nuk është e njohur për personin me njohuri në atë fushë, duke marrë parasysh njohuritë e mëparshme; (që nënkupton shpikjet që përbëjnë përparim të vërtet teknologjik në krahasim me ato ekzistuese), dhe

Është e zbatueshme në industri - Shpikja është e zbatueshme në industri nëse lënda e saj mund të prodhohet ose të përdoret në çdo lloj industrie, përfshirë edhe bujqësinë.

Patentat janë të drejta territoriale, vlejnë vetëm për shtetin ku janë regjistruar. Një shpikje duhet të jetë e patentuar në vendin tonë për të gëzuar mbrojtje. Ndërsa për mbrojtjen e shpikjes në një shtet tjetër duhet bërë regjistrimi në vendin përkatës.

Procedurat për patentim kërkojnë njohuri përkatëse të fushës, përkatësisht njohuri teknike dhe ekspertizë ligjore, andaj është e këshillueshme të kërkonin ndihmë profesionale.

Ekziston mundësia e patentimit të shpikjes:

Kombëtare: Aplikimi për patentimin bëhet në API, për patentimin e në territorin e Republikës së Kosovës.

Evropiane: Zyra Evropiane për Patenta, nëse do të zhvilloi biznesin në disa vende të Evropës atëherë është më mirë të aplikoni për patentimin e shpikjes tuaj përmes këtij sistemi.

Sipas Sistemit Ndërkombëtar: Bazuar në Traktatin për Bashkëpunim për Patenta (PCT), ju mund të regjistroni patentën tuaj duke aplikuar në së disa apo në të gjitha vendet që janë pjesë e këtij traktati. Por vlerësimi i patentshmërisë së shpikjes tuaj do të bëhet nga secila zyre për patenta në secilin shtet anëtarë, patenta do të lëshohet nga secila zyre. Pra nuk nënkupton patentë ndërkombëtare, por vetëm sistem ndërkombëtar të regjistrimit. Por shtetasit e Kosovës, duhet të kenë një lidhje me vendin anëtarë që aplikojnë, të kenë vendbanimin apo selinë e biznesit në të njëjtin, pasi që Kosova nuk është anëtare e PCT.

Mbrojtja me patentë në Kosovë zgjatë 20 vite, duke filluar nga data e dorëzimit të aplikimit për patentë. Mirëpo, pas vitit të tretë çdo vit vijues paguhet taksa e mirëmbajtjes së patentës, nëse nuk paguhet kjo taksë në afatin e paraparë mbrojtja me patentë përfundon. Pas kalimit të afatit 20 vjeçar, shpikja bie në domenin publik dhe mund të përdoret lirshëm nga gjithkush.

Personi i cili e ka të drejtën e patentës, mund të ndalojë të gjithë të tjerët të përdorin, krijojnë, shesin, ose importojnë teknologjinë që mbrohet me atë patentë. Pra, ai ka mundësinë të shes, tregtoj ose licencoj teknologjinë për personat apo ndërmarrjet e tjera që dëshirojnë të përdorin atë.

Këshillohet dhe është shumë i rëndësishëm për novatorët e bizneset që të shikojnë e qasen në platformat ku janë publikuar patentat e të drejtat e tjera pronësore intelektuale me qëllim të njohjes së trendëve më të reja të novacionit e zhvillimit në fushën përkatës dhe inspirimi.

Përparësitë e mbrojtjes me patentë:

- siguron të drejtë ekskluzive dhe mbron shpikjen edhe nëse dikush tjetër ka arritur në të njëjtën shpikje në mënyrë të pavarur;
- siguron kompanisë vlerë tregu, veçanërisht nëse një kompani ka shpikje të patentuara që janë të rëndësishme ose themelore për funksionimin e një lloji teknologjie;
- informacioni për patentën mund të përdoret më tej nga novatorët për të përmirësuar inovacionin, kështu që është burim i mirë informacioni;
- portofoli i patentave mund të përdoret si aktiv për të rritur vlerën e kompanisë, ose si aktiv për të lidhur marrëveshje bashkëpunimi.

1.2. Mbrojtja e varieteteve të bimëve

Përveç mundësisë së patentimit, është e mundur që përfitohet edhe nga mbrojtja që realizohet përmes të drejtave që kanë të bëjnë me të drejtat e seleksionuesve të bimëve. Me varietet të bimëve, nënkuptohen të drejtat që i takojnë seleksionuesit të bimëve, përkatësisht personit fizik dhe juridik që ka krijuar, seleksionuar, zbuluar ose krijuar varietetin vetë ose në bashkëpunim me ndonjë person tjetër fizik apo juridik.

Mbrojtja e varietetit të bimëve është shumë e rëndësishme për shkak të investimeve që bëhen për të arritur varietete të reja, të cilat mund të japin shembull rendimente më të larta, janë më rezistente ndaj dëmtuesve dhe sëmundjeve, apo mund ti rezistojnë më shumë thatësirave, e benefite të tjera. Por edhe mund të ndikojnë në sigurimin e ushqimit më cilësor, duke sjellë edhe kështu vlera të reja për industrinë e bujqësisë. Si dhe të ofrojnë nxitje për vazhdim ose rritje të investimit të ardhshëm kërkimor, duke i njohur drejtën ligjore seleksionuesit dhe të drejtën ekonomike për shpërblim për përpjekjet e tij ose të saj.

Sipas legjislacionit të vendit tonë Ligji Nr. 02/L-98 për Mbrojtjen e Varieteteve të Bimëve, me varietetet nënkuptojmë një bimë e cila grupohet në kuadër të një klasifikimi botanik të veçantë të një niveli më të ulët, grupet e të cilave pa marrë parasysh kushtet e rritjes mund të jenë:

1. të definuara nga të shprehurit e karakteristikave që rezultojnë nga një gjenotip i caktuar ose nga kombinimi i gjeno-tipeve,
2. të dallueshme nga çfarëdo bime tjetër të grupuara me një shprehje dhe së paku me një karakteristikë të përmendur, dhe
3. të konsiderohet si njësi që kanë të bëjnë me përshtatshmërinë për tu shumëzuar në mënyrë të pandryshueshme.

Nëse keni një varietet të bimëve që do të përmirësoj produktin e dhënë nga bima apo bimën, është shumë e rëndësishme që të aplikohet për regjistrimin të tij. Bujqit në vendin tonë duhet të shfrytëzojnë sistemin kombëtar të regjistrimit të varieteteve të reja.

Gjithashtu, është e këshillueshme për buqit dhe ndërmarrjet që merren me bujqësi, që të marrin licenca për shfrytëzim e prodhim të varieteteve të reja nga kompanitë e subjektet jashtë Kosovës.

Bujqit dhe organizatat e tyre në Kosovë duhet të punojnë bashkë me qëllim të krijimit, identifikimit dhe regjistrimit të varietetet e tyre të reja, të cilat mund të regjistrohen e të fitohet mbrojtje.

Varietetet e reja dhe emri i tyre mund të regjistrohet në Ministrinë e Bujqësisë.

Është e këshillueshme për subjektet në vendin tonë të aplikojnë për regjistrimin e varieteteve të bimëve, nëse varieteti është:

1. **i ri** - në qoftë se në datën e aplikimit ai është shfrytëzuar me pëlqimin e personit të autorizuar në Kosovë për një kohë jo më tepër se një vit, e ne rastin e aplikacionit nga jashtë jo më tepër se katër vite para datës së aplikimit si dhe për rastet me pemë dhe hardhi të rrushit jo më shumë se gjashtë vite nga data e lartcekur;
2. **i dallueshëm** - që nënkupton se varieteti është qartë i ndryshëm, në parim së paku me një karakteristikë të rëndësishme nga ndonjë varietet tjetër i njohur;
3. **uniform** - në qoftë se karakteristikat e tija të cilat janë bazë për dallimin nga varietetet tjera janë në masë të mjaftueshme uniforme në shprehjen e tyre, përkundër dallimeve apo ndryshimeve të cilat mund të priten nga karakteristikat e veçanta të shumimit të tyre;
3. **i qëndrueshëm** - në qoftë se karakteristikat relevante të tij mbesin të pandryshuara pas shumimit të përsëritshëm apo, në rastet e ndonjë cikli të veçantë të shumimit; dhe
4. **i identifikuar me emrin e përcaktuar sipas ligjit** – në qoftë emri i siguron dallueshmërinë e varietetit, që të mund të regjistrohet si emër i varietetit

Gjithashtu sipas legjislacionit në fuqi, në MBPZHR mund të bëhet edhe regjistrimi i emrit të varietetit të bimës, përkatësisht si i tillë mund të regjistrohet çdo emërtim, i cili siguron dallueshmërinë e varietetit dhe mund të konsistojë nga çfarëdo fjale, kombinim fjalësh, kombinim fjalësh dhe figurash apo kombinim i shkronjave dhe figurave, përveç nëse ligj përcaktohet ndryshe.

Në vendin tonë e drejta e seleksionuesve të bimëve vlen nga dita e njohjes së kësaj të drejte për kulturë lavërtarie dhe perimore 25 vite, ndërsa për pemë dhe hardhi të rrushit 30 vjet. Afati i mbrojtjes skadon në fund të vitit 25 përkatësisht të vitit 30 kalendarik. Pas kalimit të afatit të mbrojtjes përfundon mbrojtja e varietetit të bimëve.

1.3. Treguesit Gjeografik

Treguesi gjeografik (TGJ) është një shenjë dalluese që përdoret për të identifikuar një produkt cilësia e të cilit, reputacioni ose karakteristika të tjera të tilla janë të lidhura me origjinën e tij gjeografike. Përkatësisht, përmes tyre krijohen të drejtat e pronësisë intelektuale për produkte specifike, cilësitë e të cilave janë të lidhura në mënyrë specifike me zonën e prodhimit të tyre.

Për të funksionuar si TGJ një shenjë duhet të identifikojë një produkt që ka origjinën nga një vend i caktuar. Është me rëndësi të përmendet fakti se "vendi i origjinës" u sugjeron konsumatorëve që produkti do të ketë një cilësi ose karakteristikë të veçantë që ata e vlerësojnë dhe të paguajnë më shumë për këto produkte.

Sipas legjislacionit të Kosovës **Ligji Nr. 05 L-051 për Treguesit Gjeografik dhe për Emërtimet e Origjinës** TGJ tregojnë emrin e një rajoni, të një vendi specifik apo në raste të veçanta emrin e një shteti, që përdoret për të përshkruar një produkt që ka origjinë nga rajoni, vendi specifik ose shteti, i cili zotëron një cilësi, reputacion apo karakteristika tjera specifike të cilat vijnë si rezultat i origjinës gjeografike, prodhimi dhe/ose përpunimi dhe/apo përgatitja e të cilit zhvillohet tërësisht në zonën e përcaktuar gjeografike.

Produktet bujqësore regjistrohen si TGJ me shumë se cilët do produkte të tjera, kryesisht për shkak se kanë cilësi apo karakteristika që i marrin nga toka apo klima e një rajoni, si shembull produktet e ushqimit, verërat, pijet alkoolike, djathërat, etj. Si shembuj të njohur TGJ janë djathi Feta, pijet alkoolike Scotch, e Tequila, si produkte me cilësi të caktuara, e të njohura për origjinën e tyre gjeografike dhe për të pasur karakteristikat që lidhen me atë origjinë.

TGJ është një mundësi e mirë për të treguar lidhjen në mes të produktit dhe të cilësisë, reputacionit e karakteristikave të tij me regjionin ku është prodhuar.

TGJ mund të sigurojë një mbrojtje kolektive të të gjithë prodhuesve të një rajoni, vendi specifik ose shteti, që prodhojnë produkte e caktuara të cilat përdoren në industrinë e bujqësisë, që kanë identitet të një rajoni apo lokaliteti të caktuar.

Nëse ju veproni në një zonë gjeografike ku produktet tuaja bujqësore zotërojnë një cilësi, reputacion apo karakteristika tjera specifike të cilat vijnë si rezultat i origjinës gjeografike, ju mund të kërkontë regjistrimin e treguesit gjeografik në API.

Gjithëherë mbetet sfiduese lidhja e karakteristikave të produktit me lokalitetin e caktuar dhe vendosja e aplikimi i kriterëve të përbashkëta nga të gjithë prodhuesit. Para aplikimit për regjistrim të TGJ duhet të përcaktohet vendi apo territori gjeografik, dhe të mblidhen të dhëna e të bëhet një diagnostikimi bujqësor i territorit gjeografik. Nëse ka disa prodhues të produktit duhet të krijohet shoqata e prodhuesve dhe regjistrimi i së njëjtës, pra prodhuesit duhet të mblidhen rreth shoqatës së tyre. Përcaktimi i karakteristikave dhe cilësive të produktit, të cilat duhet të mblidhen në formë të specifikacionit të produktit, të cilit anëtarët e shoqatës duhet ti

përbahen për ti prodhuar produktet e tyre. Pas plotësimit të kërkesave dhe kushteve bëhet aplikimi për regjistrim të TGJ.

Krijimi i kushteve dhe plotësimi i kërkesave për regjistrimin e TGJ nuk është i lehtë dhe kërkon angazhim dhe organizim sidomos kur ka disa subjekte që do të përdorin të njëjtin TGJ. Në vendin tonë nuk ka ende të regjistruar asnjë TGJ. Edhe pse procesi i krijimit të TGJ për Djathin e Sharrit është në përfundim e sipër.

Nëse jeni anëtar i shoqatës së prodhuesve që posedon një TGJ, do të jeni në gjendje ta përdorni atë. Por ju duhet të respektoni në mënyrë rigorozë standardet cilësore që i ka përcaktuar organizata që ka regjistruar TGJ dhe specifikat e parapara nga TGJ, sepse me mosrespektimin tyre mund të shkatërroni reputacionin e TGJ dhe mund të dëboheni nga shoqata e si rezultat te mos keni drejtë të përdorni TGJ.

Nëse dikush tjetër do të prodhonte një produkt duke mos qenë nga vendi apo territori për të cilin TGJ është i mbrojtur dhe përdor TGJ të regjistruar, do të bënte shkelje të drejtave të mbrojtura me ligj për TGJ.

Në vendin tonë e drejta e përdorimit të TGJ zgjatë për dhjetë (10) vite që nga data e regjistrimit të përdoruesit të autorizuar në Regjistrin e Përdoruesve të Autorizuar. Mund të përtërihet pa kufizim për periudha dhjetë (10) vjeçare për sa kohë që TGJ është i regjistruar.

1.4. Markat Tregtare

Me qëllim të suksesit të biznesit dhe të identifikimit të produkteve të prodhuara bujqësore, është me rëndësi që produktet dhe shërbimet të dallohen në treg nga konsumatorët, e kjo mund të arrihet duke përcaktuar për markë tregtare (MT) një logo apo shenjë të përshtatshme për tu dalluar nga konsumatorët.

Konsumatorët e ndërlidhin markën tregtare me cilësinë dhe kualitetin e produkteve dhe shërbimeve, kjo është njëra ndër funksionet e markës tregtare, për të u dhënë konsumatorëve një lidhje me markën tregtare dhe brendin përkatës. Pra, markat tregtare mund të përdoren për të krijuar një identitet për produktet edhe në industrinë e bujqësisë, në Republikën e Kosovës kjo industri është e dyta pas industrisë së shëndetësisë, për nga numri i markave të regjistruara, përkatësisht me 17.02 % të numrit të përgjithshëm.

MT mund të përdoren shembull në sektorin e bujqësisë për mbrojtjen e farërave, produkteve të bimëve, produkteve të kafshëve, dhe produkteve të tjera. Përkatësisht produktet të cilat i keni prodhuar në kuadër të veprimtarisë tuaj biznesore bujqësore, është mirë të shiten ofrohen për konsumator, nën një markë tregtare të regjistruar, për faktin që nëse prodhoni disa produkte të cilat edhe i plasoni vet tregun e shitjes apo nëpërmjet distributoreve, konsumatorët do të mësohen me produktet tuaja.

Konsumatorët do të lidhen dhe mbajnë mend produktet duke mbajtur në mend MT. Gjithashtu sigurohen investimet tuaja nëse ju bëni reklamim apo vendosje të produkteve për shitje në pikat e shitjes, pasi që konsumatorët do të njohin brendin tuaj. Kështu ju ndërtoni imazhin e ndërmarrjes tuaj, dhe krijoni brendin tuaj. MT duhet të përdoret së bashku me një strategji të marketingut, e cila bazohet në kërkesat dhe preferencat e konsumatorëve, përmes së cilës synohet rritja e vlerës së prodhimit të sektorit të bujqësisë.

Marka tregtare është një shenjë apo simbol që dallon shërbimet apo produktet e një ndërmarrje nga një ndërmarrje tjetër. Përkatësisht marka mund të jetë një shenjë, simbol apo dizajn që dallon dhe identifikon shërbimet apo produktet e një ndërmarrje.

Disa marka tregtare të regjistruara në Kosovë për produkte bujqësore:

GOLDY

Word



Kaufland Warenhandel
GmbH & Co.KG

Podravka

Kohëve të fundit si marka regjistrohen edhe shenjat tre-dimensionale duke përfshirë formën e mallrave, paketimin e tyre, shenjat e ngjyrës, qoftë si ngjyra abstrakte të vetme ose si kombinime; hologramet e deri tek shenjat e lëvizjes ose multimediale; e shenja të tjera.

Në kuadër të strategjisë biznesore, është e këshillueshme të bëhet regjistrimi i markës tregtare para se të bëhet plasimi i produktit në treg, ose së paku të bëhet aplikimi për regjistrim. Megjithatë, është me rëndësi që të bëhet një kërkim i paraprak dhe të shikohet nëse marka përkatëse është apo nuk është në konflikt me një markë të regjistruar më parë.

Markat e regjistruar në Kosovë mund të kërkohen në faqen e API-së, në linkun: <http://213.163.122.85/wopublish-search/public/trademarks?17&query=OFCO:KS>

Me rëndësi të kujtohet çdo herë se të drejtat nga MT janë të drejta territoriale, një markë e regjistruar në Kosovë vlen vetëm për territorin e Kosovës. Pra parimi i territorialitetit vlen si për të drejtat e tjera pronësore intelektuale. Nuk ekziston markë tregtare ndërkombëtare, edhe pse ekziston një sistem ndërkombëtar i regjistrimit të markave tregtare.

Nëse një subjekt apo person nga vendi ynë kërkon të këtë mbrojtje për markën tregtare, subjekti duhet të bëjë regjistrimin e markës apo brendit në shtetet në të cilat dëshiron mbrojtjeje.

Ekziston mundësia e regjistrimit të një marke tregtare:

Kombëtare: Aplikimi për regjistrim bëhet në API, për regjistrim në territorin e Republikës së Kosovës.

Markë tregtare Evropiane: EUTM që ofron mbrojtje në tërë Bashkimin Evropian. Nëse do të zhvilloni Biznesin në disa vende të BE-së atëherë është më mirë të aplikoni për regjistrim për një markë për Bashkimin Evropian.

Sipas Sistemit Ndërkombëtar të Madridit: Mund të aplikoni në një vend anëtar të këtij sistemi dhe të kërkonti mbrojtje për vendet që dëshironi të bëni biznes. Kosova nuk është anëtare e sistemit, por mund të aplikohet në një vend anëtar, nëse keni një lidhje me të, si shembull keni vendbanimin, biznesin ose një seli të tij, etj.

Kur bëhet aplikimi për regjistrimin e markës tregtare për sektorin e bujqësisë mund të zgjidhen produktet apo shërbimet sipas Klasifikimit të Nicës, në klasat : 29, 30, 31, 32, 33, dhe 43.

1.5. Sekretit Tregtar

Sekretet tregtare (ST) janë informatat e konfidenciale të cilat kanë rëndësi komerciale për bizneset deri sa mbahen sekret. Çdo informacion mund të konsiderohet si sekret tregtar, në industrinë e bujqësisë nëse ka rëndësi komerciale, të tilla janë zakonisht si lista e furnizuesve të blerësve, strategjia e marketingut, financimit, informacioni lidhur me çmimet, metodat e ruajtjes së farërave, apo kultivimit të kulturave të ndryshme, prodhimi i kulturave bujqësore, etj.

ST mbrohet deri sa ai ruhet si i tillë. Si i tillë është, informacioni i cili ka vlerë tregtare për ndërmarrësit në industrinë e bujqësisë dhe iu siguron atyre avantazh konkurrues në treg në çfarëdo mënyre. Njëri ndër shembujt më të bujshëm të sekretit tregtar konsiderohet receta e Coca-Cola, e mbajtur si i tillë nga viti 1919, apo receta e përgatitjes së KFC-së, e të tjera raste.

Sipas legjislacionit të Republikës së Kosovës [Ligji Nr. 08 L-076 për Mbrojtjen e Sekreteve Tregtare](#), i miratuar së fundi, në fuqi nga 15 Qershori 2022, sekretit tregtar është informacion, fshehtësi në kuptimin që nuk është përgjithësisht ose lehtësisht i qasshëm për personat brenda qarqeve që zakonisht merren me llojin e informatës në fjalë, dhe që ka vlerë tregtare sepse është sekret dhe personi që e kontrollon merr masa për ta mbajtur atë sekret.

Në industrinë e bujqësisë si ST mund të mbahen shembull nuhuritë për mbjelljen e kulturave të ndryshme bujqësore, teknikat e prodhimit apo të ruajtjes së farave, përgatitja e ushqimit për kafshët, ruajtja apo konservimi i produkteve bujqësore e shtazore, informatat dhe metodat e ndryshme biznesore, dhe informacion tjetër që ka vlerë komerciale e për këtë arsyeje duhet të ruhet sekret. ST kanë rëndësi për bizneset në industrinë e bujqësisë, sikurse edhe patentat e të drejtat e tjera pronësore intelektuale.

Mbrojtja me ST, zgjatë deri mbahet si sekret apo deri sa konkurrentët nuk zhvillojnë një novacion të njëjtë në mënyrë të pavarur, apo duke analizuar produktet dhe shërbimet e kompanisë tuaj e të arrijnë të gjejnë shembull se si ju prodhoni një material të tillë.

Që një informacion të klasifikohet si sekret tregtar duhet që të plotësohen këto kushte:

Të ruhet sekret

Të ketë vlerë komerciale, dhe

Të janë marrë masa për ruajtjen sekret të tij.

ST nuk ka nevojë të regjistrohet, por mbrohet për sa kohë që mbahet sekret. Për këtë arsyeje është me rëndësi që biznesi apo kompania të merr masa për mbrojtjen e informacionit që e konsideroni si të rëndësishëm si sekret tregtar. Përfshirë që ST, të mos jetë i qasshëm lehtësisht as edhe nga punëtorët e saj, përveç atyre të cilët e kontrollojnë atë.

Ruajtja e ST, si sekret dhe konfidencial është sfidë dhe sidomos në epokën digjitale, pasi që i tërë informacioni është në formë të dhënave digjitale apo lehtë të transmetueshëm, për këtë arsyeje është e këshillueshme të merren masa:

Masa organizuese - në kuadër të kompanisë, duke trajnuar punëtorët sidomos ata që merren me informatën në fjalë për ta ruajtur si sekret; si masa parandaluese.

Masa teknologjike – përdorimi i teknologjisë së enkriptuar, vërtetimin e autenticitetit për qasje, fjalëkalime të ndryshme, për të ruajtur informacionin e klasifikuar si sekret tregtar.

Masa ligjore – duke nënshkruar marrëveshje mos zbulimi me punëtorët që kanë qasje në informacionin që është i klasifikuar si ST dhe gjatë bashkëpunimit me kompanitë e tjera. Përfshirë marrjen e masave ligjore për zbulimet e qëllimshme të paautorizuara të ST.

Në rastet e bashkëpunimit biznesor është me rëndësi të vendosni klauzola kontraktore në formë të Marrëveshjes së Mos-Zbulimit të Informacionit (NDA), duke identifikuar se cili informacion është “informacion si sekret” dhe për çfarë qëllimi mund të përdoret i njëjti, se cilët persona mund të kenë qasje nga pala tjetër në të, dhe cili do të jetë kompensimi i dëmit në rast të zbulimit të këtij informacioni. Në NDA është me rëndësi të vendosni edhe ligjin dhe juridiksionin që aplikohet në rast kontesti, nëse hyni në marrëveshje me persona të huaj.

Është e këshillueshme të mbrohen si ST edhe shpikjet nëse konsiderohet se ato mund të mbahen sekret për një periudhë më të gjatë se 20 vjet, aq sa është mbrojtja me patentë.

Shembulli i Coca-Cola, tregon se si kompania shfrytëzon sekretin tregtar të recetës për më shumë se një shekull, këtë mbrojtje aq e gjatë nuk ta gëzonte me asnjë të drejtë tjetër pronësore intelektuale. Edhe pse duhet pas kujdes nëse një shpikje mund lehtë të kundërprojektohet apo të kuptohet se si funksionon, është më me rëndësi që ajo shpikje të patentohet. Sepse nëse një kompani tjetër do të dilte me të njëjtën shpikje, ata mund ta patentonin atë dhe mbajtësi i ST nuk mund të bënte asgjë.

2. Raste Studimi

2.1. BoomGrow – Kombinimi i Mbjelljes Precize dhe Bujqësisë Vertikale¹

Një start-up agro-teknologjik me rritje të shpejtë në Malajzi po rrit prodhime të freskëta në kontejnerë transporti të ripërdorur të teknologjisë së lartë për të ofruar perime pa pesticide për klientët me gjurmë të reduktuar të karbonit. Teknologjia vertikale e bujqësisë e BoomGrow-së në pritje të patentave hap derën për bujqësinë e së ardhmes, duke kursyer hapësirë, ujë dhe transport.

Dr. Jay Desan, një nga bashkëthemeluesit e BoomGrow është një studiuese. Ajo shkroi doktoraturën e saj në standardet e përgjegjësisë korporatave në Queen Mary, Universiteti i Londrës, dhe vazhdoi të këshillojë 500 kompani të pasura shumëkombëshe mbi politikat e qëndrueshmërisë dhe qeverisjen sociale mjedisore për gati dy dekada. Kur u kthye në Malajzi, nëna e dy fëmijëve zbuloi se ishte një sfidë të gjente produkte të përballueshme dhe pa pesticide për të ushqyer familjen e saj. "Më hutoi. Po shpenzoja një pasuri të tërë për prodhime të pastra", tha ajo.

Nga bujqësia mbi kulme, në bujqësi të brendshme

Pikërisht atëherë kur Jay me dy miq e saj të vjetër Murali Krishnamurthy, me përvojë në shërbime financiare, dhe Shan Palani, një projektues dhe arkitekte, e cila ndante pasionin e saj për sigurinë ushqimore, filluan të punonin mbi idenë e bujqësisë së afërt pa pesticide.

"Ne kishim këtë vizion për nevojën për të ndryshuar mënyrën se si njerëzit jetojnë." Kompania, e nisur në vitin 2013, filloi me një projekt bujqësie në çati apo mbi kulm. "Zyra jonë ishte afër një supermarketi të vogël në lagje dhe na ofruan hapësirë në çati," kujton ajo. "Ne filluam kultivimin tonë atje, shpejt për të kuptuar se sa naivë kishim qenë." Në vendet tropikale, ka stuhi dhe është shumë nxehtë për shumicën e prodhimeve. "Dielli i mesditës vrau gjithçka," tha ajo, duke qeshur me kujtimin.

"Ajo që na kaloi, në fund, ishte elasticiteti dhe shkathhtësia jonë. Kur nuk funksiononte, ne do të provonim diçka tjetër." "Ne kemi bërë një rrugë të gjatë që nga përvoja e çatisë."

Tre bashkëthemeluesit eksploruan idenë e bujqësisë së brendshme dhe pasi përfunduan prototipin e tyre të parë të një kontejneri transporti të ripërdorur të teknologjisë së lartë, iu dha një grant qeveritar, i cili ndihmoi kompaninë të dilte nga kriza.

Fermat e makinerisë, një sistem i kultivimit vertikal Hidroponik - "Prodhimi pa pesticide pa karbon"

BoomGrow kishte një qasje të drejtuar nga kërkimi dhe zhvilloi një sistem, të quajtur "Fermat e Makinerisë", të cilat janë kontejnerë transporti të ripërdorur.

BoomGrow prodhon produkte pa pesticide të rritura në një mjedis hidroponik të kontrolluar - rrënjët e bimëve nuk rriten në tokë, por në një zgjidhje të pasuruar me lëndë ushqyese me bazë uji – bëhet monitorimi i inputeve, dritës, ujit dhe lagështisë për të optimizuar kushtet dhe

¹ Rasti i studimit është marrë nga faqja e internetit të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale OBPI në Anglisht WIPO. Sipas kushteve të përdorimit të materialeve të WIPO-së, rasti është përkthyer dhe përshtatur, ndryshime janë bërë në materialin original të prezantuar në linkun

<https://www.wipo.int/ipadvantage/en/details.jsp?id=12450>, qasur së fundi me datën 21.06.2022.


rezultatet e rritjes. Sistemi vertikal i bujqësisë së brendshme BoomGrow në pritje të patentës përdor rreth 95 për qind më pak ujë se bujqësia tradicionale dhe 95 për qind më pak tokë.



Të instaluara në kontejnerë transporti, fermat BoomGrow janë të lëvizshme, të personalizueshme dhe kanë një sistem raftimi modular. Kompania rrit zarzavate me gjethe, të tilla si lakra jeshile, chards zvicerane dhe sallatë me raketë. Në vitin 2022, BoomGrow prezantoi mikrogjelbërimet dhe po ndërmer kërkime dhe zhvillime mbi prodhimin e ardhshëm. Njerëzit në Kuala Lumpur, Klang Valley dhe Langkawi mund të marrin lakër jeshile të freskët, të rritur në qytet, gjatë gjithë vitit, pa karbon, "gjë që nuk ka ndodhur kurrë më parë, sepse ne duhej të importonim të gjitha këto produkte nga Evropa, Australia ose Japonia.", shpjegoi ajo.

Sistemi i Bujqësisë Precize i mbështetur nga Inteligjenca Artificiale

Teknologjia pronësore e bujqësisë BoomGrow u zhvillua nga ekipi BoomGrow i specialistëve të R&D, agronomëve dhe inxhinierëve të teknologjisë. Bujqësia e brendshme është mjaft komplekse, shpjegoi Jay. Sistemi përfshin harduer dhe softuer për të mbështetur të gjithë informacionin që rrjedh nga sensorët e kontrollit dhe dritat LED. "Teknologjia që kemi zhvilluar është shkrija e harduerit, softuerit dhe shkencës së agronomisë dhe lejon shumë pak ndërhyrje njerëzore."



"Mbledhja e vazhdueshme e të dhënave nga sensorët e shumtë të fermave është e vetmja mënyrë për t'u përmirësuar në atë që bëjmë," tha ajo. BoomGrow ka një qasje modulare dhe mund të lidhë disa kontejnerë transporti ose të instalojë module të vetme në qytete shumë urbane. Kontejnerët mund të vendosen edhe në ndërtesa.

Bujqësia 4.0: E ardhmja e bujqësisë e mundësuar nga BoomGrow

BoomGrow transformon bujqësinë dhe ofron bujqësi të qëndrueshme dhe të gatshme për të ardhmen. "Kur ne mund të rritim ushqim pranë vendit ku konsumatorët jetojnë dhe blejnë, kjo do të transformojë mënyrën se si jetojmë," sipas Jay.

Pronësia Intelektuale ka qenë thelbësore për BoomGrow. "Ne morëm grantin e qeverisë në bazuar në atë patentë," shpjegoi ajo. Patenta nxiti interesin për kompaninë dhe vazhdon të mundësojë BoomGrow të nxisë inovacionin. "Kjo patentë është në qendër të asaj që ne bëjmë," tha ajo. BoomGrow është gjithashtu në proces të mbrojtjes së emrit të markës së saj.

2.2. Kontrolli i ngricave dhe kursimi i të korrave - Historia e Florencio Lazo Barra²

Florencio Lazo Barra u trajnuar si arkitekt, por mori përsipër menaxhimin e fermës së qumështit të familjes së tij në Kili pas vdekjes së babait të tij. Në vitet 1970, kur Kili filloi të promovonte eksportet e tij bujqësore dhe pyjore, z. Lazo vendosi ta kthente fermën e qumështit në pemishte për të prodhuar fruta për tregun ndërkombëtar.

Në vitin 1991, rajoni qendror i Kiliti VI O'Higgins u prek nga një ngricë e fortë që nuk i kurseu kopshtet frutore të zotit Lazo: ai humbi 100% të prodhimit të rrushit të tryezës dhe 80% të kumbullave. Ai ka bërë shpenzime të larta edhe për karburantin e djegësve të naftës, të cilin e përdori në përpjekjen e dështuar për të mbrojtur pemishtet e tij nga ngrica. Në të njëjtin vit, ai vendosi të krijonte një metodë të kontrollit të ngricave që do të ishte më efikase dhe ekonomike se ato ekzistuese. "U betova se nuk do t'i shihja më të mbjellat e mia të ngrira", kujton zoti Lazo.

Kërkimi dhe Zhvillimi

Një vit më vonë, zoti Lazo u përpoq të mbronte pemishtet me një sistem zjarresh të bërë vetë, duke përdorur kazanët e naftës. Ndërsa ky prototip i parë rezultoi i paefektshëm, ai përsëri e bindi atë se ajri i nxehtë, kur aplikohet në fushë në një mënyrë të veçantë me aerodinamikë të sofistikuar, mund të krijonte një pengesë termike të përkohshme ndaj ngricave. Z. Lazo testoi opsione të ndryshme, duke përfshirë mundësinë e përdorimit të helikopterëve për të përzier ajrin e ftohtë në tokë me atë më të ngrohtë lart, dhe më në fund filloi të eksperimentonte me aplikimin e ajrit të nxehtë në tokë.

Pas katër vitesh eksperimentesh të mëtejshme, një prototip i parë i punës, Lazo Frost Control Machine ("Lazo FCM"), u testua me sukses në vitin 1996. Lazo FCM është një ventilator i fuqishëm centrifugal me një ngrohës, i cili tërhiqej nëpër fushë nga një traktor. Duke funksionuar me katër cilindra të gazit të lëngshëm prej 45 kilogramë, siguron karburant deri në pesë orë, ventilatorët nxjerrin ajrin e nxehtë anash nga dy daljet dhe mbulojnë një distancë deri në 100 metra në secilën anë të makinës. Futja e një shtrese ajri të nxehtë në masën ajrore të ftohtë që rrethon bimët mbron frutat dhe perimet nga ngrica.

Përparësitë kryesore të Lazo FCM janë lëvizshmëria e tij (jo një instalim fiks), kostoja e ulët e funksionimit (5 për një orë për një hektar: të paktën tre herë më e lirë se sistemet e tjera), fleksibiliteti (aftësia për të kontrolluar ngricën e rrezatimit dhe të ngjitjes), miqësoria me mjedisin (përdorimi i gazit propan) dhe efektiviteti (krijimi i një shtrese të qëndrueshme të ajrit të nxehtë).

Financimi dhe regjistrimi i IP

Sapo prototipi Lazo FCM u testua me sukses, z. Lazo aplikoi për ndihmë nga "Innova Chile", një agjenci qeveritare për të promovuar inovacionin (atëherë e quajtur Fondi Kombëtar për Zhvillimin e Teknologjisë dhe Prodhimit [FONTEC]), dhe mori 170,000 USD, që ta kthejë idenë e tij të biznesit në realitet dhe të prodhojë më shumë makina. "Brenda muajsh filluan të vijnë porosi nga fermerët kilianë dhe mendova: kjo ndodh një herë në jetë. Fitova lotarinë dhe kishte ardhur koha për të patentuar", kujton ai.

² Rasti i studimit është marrë nga faqja e internetit të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale OBPI në Anglisht WIPO. Sipas kushteve të përdorimit të materialeve të WIPO, rasti është përkthyer dhe përshtatur, ndryshime janë bërë në materialin origjinal të prezantuar në linkun <https://www.wipo.int/ipadvantage/en/details.jsp?id=2448>, qasur së fundi me datën 21.06.2022.


Në vitin 1997, me ndihmën e një eksperti të pronësisë intelektuale (PI), ai filloi procedurën e marrjes së patentës jashtë vendit. SHBA ishin vendi i parë që i dha shpikjes së tij një patentë.

Në Kili, patenta nr. 41776 u dha në vitin 2002 nga Departamenti i Pronësisë Industriale për një makinë për të kontrolluar ngricat, e cila punon me një ventilator centrifugal me dy priza, duke përdorur një ngrohës dhe që lëviz nëpër arat e montuara në një traktor bujqësor. Shpikja mbrohet gjithashtu nga një patentë në vende të tjera, duke përfshirë Argentinën, Australinë, Kinën dhe Bashkimin Evropian.

Firma gjithashtu ka një markë tregtare të regjistruar në Departamentin e Pronësisë Industriale të Kilit.

Komercializimi dhe Rezultatet e Biznesit

Në vitin 1997, z. Lazo filloi komercializimin e teknologjisë së tij në Kili. Një vit më vonë, teknologjia Lazo FCM u eksportua në SHBA duke i dhënë një licencë prodhimi Agtec Crop Sprayers (tani "Superb Horticulture"), e cila shet produktin me emrin "Lazo Frost Dragon". Në 3 vitet e para, mbi 500 makina u shitën në Amerikën e Jugut dhe SHBA.



Në vitin 1999, Z. Lazo fitoi Çmimin Kombëtar për Inovacionin Bujqësor të dhënë nga Ministria Kiliane e Bujqësisë. Në vitin e ardhshëm, shitjet dhe shpërndarja filloi në Evropë, përmes Agrofrost N.V., një kompani me bazë në Belgjikë që shet dhe shpërndan makineritë në të gjithë Evropën me emrin "Lazo Frostbuster". Kohët e fundit, teknologjia u eksportua edhe në Zelandën e Re dhe Australi.

Foto: Vizatim nga Patenta e regjistruar në SHBA, nr. 5,934,013 që mbron "metodën e kontrollit të ngricës bujqësore" të Z. Lazo

Shpirti shpikës i z. Lazo nuk pushoi pas komercializimit të suksesshëm të shpikjes së tij: bazuar në FCM Lazo, ai filloi të zhvillonte një zgjidhje termike të kontrollit të dëmtuesve (TPC) që përdoret për të menaxhuar dëmtuesit dhe sëmundjet në prodhimin bujqësor pa pesticide. Qasja e tij unike dhe e mbrojtur me patentë TPC përdor ajrin e nxehtë për të ndryshuar mikromjedisin e të korrave dhe është testuar me sukses në shumicën e kulturave të frutave dhe perimeve. Sot, teknologjia TPC jo toksike, jo kimike dhe miqësore me mjedisin është duke u nisur nga kultivues të zgjedhur në Evropë, Amerikën e Veriut, Amerikën e Jugut, Afrikë, Zelandën e Re dhe Australi.

Vështirësitë ushqejnë kreativitet dhe inovacion

Ndërsa humbja e pjesës më të madhe të të korrave të zotit Lazo ishte një ngjarje fatkeqe, ajo çoi në dy shpikje novatore të cilat kanë rritur sigurinë ushqimore duke kontrolluar ngricat me një zgjidhje të lirë dhe reduktuar ndotjen përmes kontrollit termik të dëmtuesve (TPC). Patentat mbrojnë shpikjet e zotit Lazo dhe lehtësojnë transferimin e teknologjisë nëpërmjet marrëveshjeve të licencimit, të cilat nga ana e tyre ndihmojnë në financimin e inovacioneve të reja.

3. Mesazhe me rëndësi

- Novacioni dhe teknologjia në industrinë e bujqësisë është shumë me rëndësi, për të krijuar produkte më rentabile, më të qëndrueshme ndaj temperaturave, sëmundjeve, apo për teknologji e mjete pune që ndikojnë pozitivisht si në aspekt të kryerjes së punëve ashtu edhe të rritjes së rendimenteve;
- Është shumë e rëndësishme për novatorët dhe NVM që të kërkojnë forma të partneritetit si për zhvillimin e produkteve ashtu edhe për gjetjen e fondeve për të financuar novacionin e tyre;
- Regjistrimi i varieteteve të veçanta bimore që përmirësojnë produktet është shumë i rëndësishëm, regjistrimi bëhet pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- Nëse veproni në një zonë gjeografike ku produktet tuaja bujqësore zotërojnë një cilësi, reputacion apo karakteristika tjera specifike të cilat vijnë si rezultat i origjinës gjeografike, është shumë i rëndësishëm bashkëpunimi ndërmjet buqëve por edhe ndërmarrjeve të zonës, me qëllim të përcaktimi i karakteristikave dhe cilësive të produktit, me qëllim të krijimit të parakushteve për regjistrimin e Treguesit Gjeografik.
- Mbani shënime mbi novacionin dhe kreativitetin tuaj, identifikoni se cilat janë objektet e pronësisë intelektuale që ju i keni krijuar, regjistroni dhe i mbron ato;
- Produktet dhe shërbimet në industrinë e bujqësisë mund të mbrohen nga disa shtresa të mbrojtjes të DPI-së, të cilat duhet të shfrytëzohen e menaxhohen mirë nga ndërmarrjet e novatorët në këtë fushë, si me patentë, tregues gjeografik, markë tregtare, mbrojtja e varietetit të bimëve, dhe sekretit tregtar.
- Kërkonte ndihmë profesionale për regjistrimin e DPI-vë, e sidomos për regjistrimin e mbrojtjes e shpikjeve me patentë, varietetit të bimëve apo për treguesit gjeografik;
- Risni dukshmërinë, atraktivitetin dhe vlerën e produkteve tuaja në treg dhe dalloni biznesin tuaj dhe produktet e tij nga konkurrenca;
- Mos përdorni DPI-të e personave të tjerë pa marrë leje apo pëlqimin e tyre sepse mund të paditeni dhe humbni shumë;
- Përdorimi i të drejtave pronësore intelektuale u jep kompanive mundësi të krijimit të bashkëpunimit dhe sigurimit të pozitës me të mirë në treg;

Përdorni shenjat e DPI për të drejtat e regjistruara: Për shpikjet e patentuara "Patenta e Regjistruar"; Për të drejtën e autorit ©; Për markë tregtare ® ose "Markë e Regjistruar" Për Dizajnë të Industrial ID.

4. Linqe me rëndësi

- Agjencia për Pronësi Industriale e Kosovës: <https://kipa.rks-gov.net/>
- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural <https://www.mbpzhr-ks.net/sq/ballina>
- WIPO: www.wipo.int
- EPO: <http://www.epo.org>
- USPTO: <https://www.uspto.gov>
- WIPO SME Division: www.wipo.int/sme
- WTO: <http://www.wto.org>
- EU: Geographical indications - https://europa.eu/youreurope/business/running-business/intellectual-property/geographical-indications/index_en.htm
- Directory of IP Offices worldwide: <http://www.wipo.int/directory/en/urls.jsp>
- International Trademark Association (INTA): <http://www.inta.org>